KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Janar 2024

23.02.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin janar 2024.

Deficit tregtar më i lartë për 9,6% në muajin janar 2024, krahasuar me muajin janar 2023

Të dhënat nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 9,9% në muajin janar 2024, në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2023, gjegjësisht në vlerë prej 319,7 milion Euro, krahasuar me deficitin prej 291,5 milion Euro në vitin 2023. Eksporti mbulon importin me 15,9%.

Eksporti i mallrave në muajin janar 2024 kishte vlerën 60,3 milion Euro, ndërsa importi 380,0 milion Euro, që është një rënie prej (-3,0%) për eksport, si dhe një rritje prej 7,4% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Qarkullimi e mallrave në tregtinë e jashtme



Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 25,4% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 19,3% e përbëjnë artikuj të ndryshëm të prodhuar; 13,1% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 8,3% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 6,2% e përbëjnë makineria dhe pajisjet mekanike dhe elektrike, etj.

Eksportet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 17,2% e përbëjnë produktet minerale; 11,6% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11,6% e përbëjnë makineria dhe pajisjet mekanike dhe elektrike; 11,2% e përbëjnë mjetet e transportit; 9,3% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre, etj.

Importet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Eksportet dhe importet sipas vendeve në vlerë dhe %

(në mijë Euro)

Vendet	Janar - 2023		Janar - 2024	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	**62 175**	**100,0**	**60 319**	**100,0**
27 vendet e BE_së	19 773	31,8	18 413	30,5
Cefta	25 965	41,8	21 767	36,1
Të tjera	16 437	26,4	20 139	33,4
	Importet (CIF)			
Gjithsej	**353 720**	**100,0**	**379 978**	**100,0**
27 vendet e BE_së	149 305	42,2	164 363	43,3
Cefta	54 465	15,4	57 625	15,2
Të tjera	149 950	42	157 990	41,6

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 18,4 milion Euro, ose rreth 30,5% e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-6,9%). Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (8,8%), Italia (4,7%), Holanda (3,1%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 164,4 milion Euro, ose 43,3% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 10,1%. Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (12,8%), Greqia (7,2%), Italia (3,7%), etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 21,8 milion Euro, ose 36,1% të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-16,2%). Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e Veriut (12,4%), Shqipëria (11,8%), Serbia (6,3%), Mali i Zi (3,9%).

Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 57,7 milion Euro, ose 15,2% të importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-5,8%). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (7,6%), Maqedonia e Veriut (4,7%), Serbia (1,9%).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 20,1 milion Euro, ose 33,4%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: SHBA (14,6%) dhe Zvicra (9,3%).

Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 158,0 milion Euro, ose 41,6%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (15,4%) dhe Kina (11,3%).

Për më shumë informata, lidhur me Statistikat e Tregtisë së Jashtme për muajin janar 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/ForeignTrade